

# Hylli i Dritës

*Ubi Spiritus Domini, ibi libertas.*

(II. ad Cor. III. 17).

---

1. E para Ekspozitë Artizanati në Tiranë e zhvillimi i pûnës në Shqypni	Fq. 369
2. Sporti e breznija e ardhshme	„ 376
3. Spiritizmi në dritë t' arsyes	„ 386
4. Akcenti n' orthografi t' onë	„ 396
5. Bejlegu ndermjet dy vllazenve të pa- njoftun (Rapsodi)	„ 410
6. Kisha katolike e Galileo Galilei	„ 424
7. Nji dorshkrim i vjetës 1671 mbi Shqypni	„ 434
8. Mndash prej gjethve të mandit	„ 448
9. Mirdita (Prengë Bibë Doda)	„ 452
10. Per „Visarin komtâr“	„ 462
11. Ëmzot Luigj Çurçija në Pësdhjetvjetuer të dekës së vet	„ 467
12. Nder Lamije të Diftunis	„ 477


---

SHKODER

Shtypshkroja Françeskane

1931.

## POSTA E JONË

 **PAJTIMTARVE: U a vonuem pak të Perkohshmen ksajë herë, por, si shifet edhe në syprinë, deshtem me u dergue dy muejë më një, Korrik e Gusht, rrumull 112 faqe, per me u dhënë pjeshtarve të Redakcionit t' onë pushimin e merituem në kto muejë lirimesh. Të mirë u pashim prandej në Shtatuer!**

**TIRANË:** *M. P: Jemi habitë edhe na më teper! Na falni eç ne u vonuem dergimin e të tanë numrave, kah pritem të kryejm edhe ket numer per me u a çue të gjith më një. Prejse u diejm per aq t' interesuem per Rivistë t' onë, as na nuk mund të diftohemi fort të shterngueshem me Jue.*

**TIRANË:** *A. B. Jemi bindë pernjimend! Ka këne një mosmarrveshtje e habi e jona në rreshtim t' ëmnave të pajtimtarve e kurrgjã ljeter: prandej lutemi të na falni.*

**TIRANË:** *L. S. Per një numer në vjelë as per „Librari“ nuk mund të bëjm kurrnji „ të zbritun të skontit“*

**ITALÍ:** *\*\*\* Erdh vonë, prá, pernjimend, sidomos per vend qi atij i perkítte, prandej vijuem n' at muej n' artikull aq të dishruem prej Jush.*

*Per shka na u lutshi „fort“ dijm me u thënë se jemi mundue me diftue má të madhin kujdes e kishim me thënë*

## E para Ekspozitë Artizanati në Tiranë e zhvillimi i pûnës në Shqyqni.

Nieri në histori gjithmonë na paraqitet i shoqñueshem. Kúr të mirret para sýsh, se nieri ásht i pajisun me arsye — shise e vullndet — e lypë vetë natyra e tij, qi të permirsohet fizikisht e moralisht; fizikisht, tue i a bâ sa mâ të letë e t' andshme ekzistencen mbi tokë; moralisht, neper zhvillim të mendes e zotnim të vullndetit tue e bâ sa mâ t' aftë, per t' u kapë m' qellim të vet. Tash, per të vue kto dý perlime, lypet shum pûnë e mund, e shum zêje e marifete, sa, po thue nuk ásht e mundshme, qi nji nieri t' i pranojë të gjitha m' ved-vedi: sidomos kúr të mendohet, se edhë trupi i tij ásht teper i njomë e i thyeshem, e se vetë aj ká nevojë me kênë majtë e gurvñue prej tjerret. Prandej ká kênë pûnë e domosdoshme, qi njerzt të jetojshin në shoqñi, per t' i nihmue njani tjetrit. — Teorít e disá të patenzonvet, mbas të cillave nieri, rrjedhë prej ndonji majmuni a shkerbeje tjetet, jetoj vetmas nder py-je, tuj u ushqye — si harusha — me molla e dardha t' egra, e se vonë e vonë u shoqñue me njerz tjerë e ngrefi Shtete, katunde e gjytete, pa tjetet janë per t' u shtí në senjuer të prallavet. Historija na rrfen, po, se popuj të gjytetnuem, neper kataklizme shoqñore, prej gjêjes së gjytetnis kan rá në gjêje t' egersís; por kurrkund nuk na paraqet, se nji popull i eger, barbar a primitiv, ásht gjytetnue fjeshtë neper fuqí të veta. Nieri ká kênë e ká per të kênë gjithmonë **animal rationa-**

**le, politicum, sociale:** frymuer i arsyeshem, plymsë e shoqnuer.

U tha se njerzt jetojn në shoqni, per t' i nihmuem njani tjetrit. Prej fjalvet: *per t' i nihmue njani tjetrit*, merret vesht mâ parë, se nieri ká *detyrë* me pûnue: po s' punoi, s' ká si i nihmon vedit as tjerve; së dyti, se nieri ká *tager* edhe m' perpjestim të prodhimit të punës së tjetvet. Puna prá e perpjestimi i prodhimit të pûnës hîn në natyrë të shoqnis civile. Pûna ásht, si me thânë, *materia* e jetesës në shoqni civile, e perpjestimi i prodhimit të punës *forma* e sajë. Prandej termometri i perparimit e i gjytetuís së nji populli ásht zhvillimi i punës e kriteret mbas së cillavet bâhet perpjestim i prodhimit të punës. Po kje se nji popull me sa mâ pak mund prodhon aq, sa i duhet, per me vue jo veç nevojët e para të jetës, por edhe të dobijshmet e të kandshmet, zêhet se gjindet në nji shkallë të naltë të perparimit — *permirsimi fizik a materjal i nierit* —; po kje masandej se perpjestimin e prodhimin e punës ndermjet bashkgjytetasvet e bân mbas arsyejet e drejtsís, e ká ligjë e institute të rregullshme, per të mprojtë tagret e secillit, e secillin me e ngushtue të kryej detyrët, tuj e bâ t' aftë per me u kapë m' qellim të vet, at herë ky popull ásht i gjytetnuem — *permirsimi moral i nierit* — Per ndryshe, edhe në mos kjoftë i eger, njifet per popull barbar. Puna pra, në rend logik, ásht faktori i parë i gjallnis së shoqnis civile.

E qe arrsyeya, per të cillen poetë, filozofë e dijetarë mâ të mdhej të njerzimit kurdoherë, me fjalë të bukura e të zgjedhuna kan levdue punen e kanë kshillue njerzt mos me lshue punen doret, per mbas moshës, gjêjes e mndorjevet të secillit. Pa múnd s' fitohet gjâ, thotë (*Sofokliu*). Të gjith do të punojn, e kurrkush s' do të rrij harû, sado i pasun qi të jét

